

e Punëve të Brendshme) si dhe privatizimin e këtyre banesave mbi bazë të VKM Nr.46, datë 29.01.1993 *“Për trajtimin e banesave në proces nga viti 1992”*.

Këshilli i Ministrave me VKM Nr.379, datë 26.06.1995 *“Për disa shtesa e ndryshime në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.81, datë 28.02.1994”*, ka shtuar se : *“Bashkitë ose këshillat e rretheve t’i kthejnë këto objekte në fond banese, sipas listave që do t’u dërgojë Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Brendshme”*

Edhe pse Ministria e Mbrojtjes apo Ajo e Rendit (sot Ministria e Punëve të Brendshme) kanë dërguar listat e objekteve për kthim në fond banese të objekteve që kanë mbetur të lira nga ristrukturimi, rezulton se, Këshilli i Rrethit, Tiranë, Bashkia Tiranë, Bashkia Himar, Komuna Farkë, nuk kanë bërë të mundur ushtrimin e funksioneve sikurse përcaktuar në pikën 3 të VKM Nr.379, datë 26.06.1995 *“Për disa shtesa e ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.81, datë 28.02.1994”*, duke mos u shprehur për detyrimin, apo duke mos e pranuar atë si një detyrim ligjor.

Përkundër kësaj situate ligjore në të cilën parashikohet mënyra e kalimit në fond banese e objekteve ekzistuese të Ushtrisë apo Ministrisë së rendit Publik (sot Ministria e Punëve të Brendshme), në raste të veçanta konstatohet se, Këshilli i Ministrave me VKM Nr. 327, datë 29.04.2011, i ndryshuar, të ketë vendosur *“Për kalimin në fond banese të ish-objekteve të dala nga ristrukturimi i Ministrisë së Brendshme, me qëllim privatizimi, në emër të banorëve, nga Enti Kombëtar i Banesave”*. Pra, sipas këtij vendimi është mundësuar kalimi në fond banese i disa objekteve si dhe është ngarkuar Enti Kombëtar i Banesave të lidh kontrata për privatizimin e tyre në favor të subjekteve të përmendur në këtë vendim.

Subjektet që kanë prezantuar shqetësimin e tyre për mosdhënien e mundësisë së privatizimit të objekteve të dhëna në përdorim, në kushtet e pamundësisë së ushtrimit të së drejtës të njohur me VKM Nr. 81, datë 28.02.1994, i ndryshuar, kanë kërkuar zgjidhjen e kësaj çështjeje në rrugë gjyqësore. Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Vlorë, edhe pse ka vendosur me Vendimin Gjyqësor të formës së prerë Nr. 2580, datë 27.10.2009, lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit, Vlorë, me Vendimin nr. 557, datë 03.06.2010, për :

“Detyrimin e palëve të paditura Enti Kombëtar i Banesave, Dega Vlorë, Bashkia Himar, për të vazhduar procedurat për ndryshimin e destinacionit dhe privatizimit të objekteve të ushtrisë në të cilat janë strehuar paditësit Sihat Haxhiqaj, Kozeta Bajrami, Dervish Mukaj, Fiqiret Breshanaj, Afrim Toro, Isuf Lutaj, Artur Zani, dhe person i tretë, ndërhyrës dytësor i bashkuar me palën paditëse Arben Hoxhaj”, ky vendim gjyqësor nuk ka gjetur rrugën e ekzekutimit ende sot e kësaj dite, për shkak se, Ligji Nr.8405, datë 17.09.1998 *“Për Urbanistikën”* i cili parashikonte në nenin 49, se:

“Drejtoria e urbanistikës në Bashkinë e Tiranës dhe seksionet e urbanistikës në rrethet dhe qytetet e kategorisë së parë shqyrtojnë kërkesat për leje ndërtimi për :

- leje për ndryshim destinacioni të objekteve ekzistuese,

Këto kërkesa shqyrtohen nga këshillat teknike përkatëse sipas procedurës së përcaktuar në nenin 22 dhe miratohen nga kryetari i bashkisë a kryetari i këshillit të rrethit të kategorisë së parë...”.

është shfuqizuar me ligjin Nr. 10119, datë 23.04.2009 *“Për planifikimin e territorit”*. Por, edhe pa ndodhur shfuqizimi i ligjit nr.8405, datë 17.09.1998 *“Për Urbanistikën”*, përsëri komunat, bashkitë që nuk kanë qënë dhe nuk janë rreth, dhe as qytet i kategorisë së parë, kanë qënë në pamundësi respektimi të pikës 3, të VKM Nr. 81, datë 28.02.1994, të ndryshuar, në kuptim dhe zbatim të nenit 49 të ligjit nr.8405, datë 17.09.1998 *“Për Urbanistikën”*. Gjithashtu, suprimimi i këshillave të rretheve përbën një tjetër arsye se

përse është e pamundur kryerja e procedurave sikurse përcaktuar në pikën 3 të VKM Nr. 81, datë 28.02.1994, i ndryshuar.

Ndodhur në kushtet, kur një numër i konsiderueshëm subjesh kanë qënë dhe janë të interesuar në vite për kryerjen e procedurave të privatizimit të objekteve të mbetura të lira nga ristrukturimi i Ushtrisë dhe Ministrisë së Rendit Publik (sot Ministria e Brendshme) dhe të dhëna në përdorim atyre, gjykojmë se, është e nevojshme marrja e masave të menjëhershme për mundësimin nga ana ushtarakëve, ish-ushtarakëve dhe personave apo punonjës civil të ushtrimit të së drejtës të përfitimit në pronësi të objekteve të dhëna në përdorim.

Duke pasur parasysh pengesat në zbatimin praktik të VKM Nr.379, datë 26.06.1995, gjykojmë se, është nevojë imediate, angazhimi i Këshillit të Ministrave për mundësimin e ndryshimit të këtij vendimi, me qëllim lehtësimin e procedurave të privatizimit të objekteve të mbetura të lira nga ristrukturimi i Ushtrisë apo Ministrisë së Rendit (sot Ministria e Punëve të Brendshme). Për arsyet e bërë me dije në këtë shkresë, bazuar në nenin 63/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë në të cilin parashikohet se : *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive nga Administrata publike”*, si dhe nenin 21/b të Ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, i ndryshuar, i cili parashikon se : *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që ka shkaktuar shkeljen”*,

REKOMANDOJMË

Përgatitjen dhe nxjerrjen e aktit i cili mundëson ndryshimin e pikës 3, të VKM Nr.81, datë 28.02.1994 “Për kthimin në banesa të objekteve që mbeten të lira nga ristrukturimi i Ushtrisë dhe Ministrisë së Rendit Publik”, ndryshuar me VKM Nr.379, datë 26.06.1995 “Për disa shtesa e ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.81, datë 28.02.1994”.

Lidhur me shqyrtimin që do të kryhet rekomandimit të dhënë, konform nenit 19 të Ligjit Nr.8454, datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, të ndryshuar, kthimi i përgjigjes duhet të bëhet brenda 30 ditëve nga data e dërgimit të kësaj shkrese.

Duke besuar në bashkëpunimin tuaj.

AVOKATI I POPULLIT

Igli TOTOZANI

**Konceptoi dhe Daktilografoi
A.Gjoleka**